Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0751
Data e Vendimit: 09.10.2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së OE Shkëlqimi Invest SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objekte administrative, arsimore dhe shëndetësore te Komunës se Ferizajt" me numër të prokurimit 656-23-8880-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK)–Komuna Ferizaj, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me 09/10/2023, mori këtë:

Vendim

1. Hedhet si e palejuar, ankesa e "Shkelqimi Invest" SH.P.K. me Nr. të protokollit 2023/0751, e datës 02/10/2023 e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objekte administrative, arsimore dhe shëndetësore te Komunës se Ferizajt", me numër të prokurimit 656-23-8880-1-1-1, iniciuar nga KOMUNA FERIZAJ në cilësinë e autoriteti kontraktues (AK).

2. Nuk i lejohet, autoritetit kontraktues – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objekte administrative, arsimore dhe shëndetësore te Komunës se Ferizajt", me numër të prokurimit 656-23-8880-1-1-1", ngase lidhur me këtë aktivitet të prokurimit është pranuar edhe ankesa me numër protokolli 756/23, e cila është në procedurë shqyrtimi në OSHP.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik e-prokurimi me datë 02.10.2023, tek rubrika e ankesave ka pranuar një ankesë nga OE Shkelqimi Invest SH.P.K, për aktivitetin e prokurimit me "Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objekte administrative, arsimore dhe shëndetësore te Komunës se Ferizajt" me numër të prokurimit 656-23-8880-1-1-1, iniciuar nga Komuna Ferizaj, në cilësinë e autoritetit kontraktues.

Zyra e pranimit të ankesave pas pranimit të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka ofruar dëshminë siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së.

OE ankues me datën 03.10.2023 ka dërguar një email në adresë të OSHP duke theksuar "*Ju luten te anuloni ankesën me nr. 2023/0751 e bere për Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objekte administrative, arsimore dhe shëndetësore te Komunës se Ferizajt.Sepse gabimisht gjate ngarkimit te pagesës e kemi ngarkuar pagesën e pa nënshkruar-pa paguar dhe pastaj nuk mundem ta vendosim përsëri.Ju lutem ta pranoni dhe trajtoni vetëm ankesën me nr. 2023/0756"*

Nga provat e prezantuara vlerësohet se ankesa e parashtruar nga OE Shkelqimi Invest SH.P.K, e datës: 02.10.2023 (protokoll 751/2023), për aktivitetin e prokurimit me titull me "Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objekte administrative, arsimore dhe shëndetësore te Komunës se Ferizajt" me numër të prokurimit 656-23-8880-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Ferizaj, konsiderohet si e pa kompletuar sepse ankuesi nuk ka deponuar tarifën e sigurimit të ankesës së tij siç kërkohet në piken 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së lidhur me nenin 118 të LPP-së. Andaj procedura e shqyrtimit të kësaj ankese përfundon në ketë fazë duke e hedhur të njëjtën si jo e plotë ngase kjo ankesë nuk plotëson kushtet për tu proceduar më tutje siç kërkohet dispozitat ligjore të lartcekura. Ndërsa ankesa e evidentuar me numër protokolli 756/23 e parashtruar nga i njëjti operator ekonomik Shkelqimi Invest SH.P.K për aktivitetin e prokurimit Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objekte administrative, arsimore dhe shëndetësore te Komunës se Ferizajt" me numër të prokurimit 656-23-8880-1-1-1 është në procedurë shqyrtimi në OSHP.

Autoritetit kontraktues – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, nuk mund të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit (e përshkruar me sipër) sepse i njëjti operator ekonomik "Shkelqimi Invest" SH.P.K ka parashtruar serish ankesë në OSHP po për këtë aktivitet të prokurimit, e evidentuar me numër protokolli 756/23, e cila është në procedurë shqyrtimi në OSHP.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vjosa Gradinaj
Kryetare e OSHP-së

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA FERIZAJ**
- OE - **Shkelqimi Invest SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: